

GJYKATA THEMLORE GJAKOVË DEGA MALISHEVË, Departamenti i përgjithshëm Divizion Civil, me trupin gjykues të përbërë nga gjyqtari Haki Kryeziu, kryetar i trupit gjykues, dhe gjyqtareve porotë Sejdi Morina dhe Musa Mazreku anëtar, si dhe me Sekretaren Juridike Fatime Hoti, në çështjen juridike të propozuesve, K. W. K. , e lindur me dt. ... në O. me vendbanim në B. K.-P. rr. L. K. nr....,P., e përfaqësuar nga avokati A. K. nga M., si dhe të propozuesit L. B., i lindur me në K., Komuna e M., e përfaqësuar nga avokatja L. J. nga M., lidhur me zgjidhjen e martesës me propozim të përbashkët, në shqyrtimin jo publik të mbajtur me datë 30.01.2019, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. Zgjidhet martesë me marrëveshje në mes propozuesve K. W. K. , e lindur me dt. ... në O. me vendbanim në B. K.-P. rr. L. K. nr....,P., dhe L. B., i lindur me ... në K., Komuna e M. , martesë e lidhur me dt. në zyrën e gjendjes civile në M.,K., me nr.rendor .. dhe numër të referencës ...,çertifikatë e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në M.,K. me dt. 16.08.2018.
- II. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A R S Y E T I M

Propozuesit për mes të autorizuarve të tyre në këtë gjykatë me datën, 18.12.2018, kanë parashtruar propozim të përbashkët për zgjidhjen e martesës me marrëveshje duke theksuar ndër tjera se propozuesit kanë lidhë martesë me datë, ... në M., K. e cila martesë është evidentuar sipas numrit rendorMarrëdhëniet bashkëshortore mes tyre në fillim kanë qenë të mira, mirpo ato më vonë janë përkeqësuar, për shkak të botëkuptimeve të ndryshme .Në bashkësi martesore kanë jetuar deri para dy viteve dhe që nga atëherë jetojnë ndaras.Nga kjo martesë ata nuk kanë fëmijë as që pritet lindja e tyre.

Gjykata me datë 30.01.2019, ka mbajtur seancën kryesore ,ndërsa sa i perkët seancës së pajtimit të bashkëshortëve gjykatat nuk ka mbajtur këtë seancë për faktin së propozuesit nuk kanë marr pjesë në seancën kryesore ,por kanë qenë të perfaqësuar nga të autorizuarit e tyre.

Gjatë seancës kryesore i autorizuari i propozueses K. W. K. , e lindur me dt. ... në O. me vendbanim në B. K.-P. rr. L. K. nr....,P., ka mbetur në tërësi pranë propozimit për zgjidhjen e martesës duke shtuar se bashkëshortet në zyrën e gjendjes civile në M.,K. me dt., kanë lidhur martesë nga e cila martesë kanë bashkëjetuar deri para dy viteve, dhe nga ajo kohë të njëjtit jetojnë ndaras.Në fillim të martesës raportet mes tyre ishin të mira mirëpo ato keqësohen me vonë në menyrë serioze për çka edhe nuk kanë mundur qe ti kthehen bashkëjeteses martesore.Duke pasur parasysh faktin se të njëjtit edhe për kundër përpjekjeve për rivendosje të martesës dhe fakti se jetojnë ndaras ka rezultuar se qëllimi i martesës në mesë tyre e ka humbur kuptimin dhe se tani më nuk ekziston, të njëjtit kanë vendosur që ta zgjidhin martesën me marrëveshje për çka edhe gjykatës i propozon zgjidhjen e martesës me marrëveshje.

E autorizuar e propozuesit në seancën kryesore ka mbetur në tërësi pranë propozimit duke i propozuar gjykatës që martesë të zgjidhet me marrëveshje.

Gjykata në procedurën e provave ka shqyrtuar çertifikatën e martesës me numër rendor ... dhe me numër të referencës

Pas shqyrtimit të bazueshmërisë së propozimit e së bashku me provat mbështetëse dhe pas deklarimeve të autorizuarve të propozuesve, gjykata konstatoi dhe vërtetoi se propozuesit kanë lidhur martesë me datë 30.06.2015, në Zyrën e Gjendjes Civile në M.,K. Komuna e Malishevës me numër rendor ... dhe me numër të Referencës Marrëdhëniet bashkëshortore mes tyre në fillim kanë qenë të mira ,por më vonë vonë keqësohen, për shkak të botëkuptimeve të ndryshme dhe mardhënjet e tyre janë qrrregulluar shpesh duke pasur mosmarrëveshje ndërmjet tyre.Bashkëshortët tani jetojnë ndaras.Nga kjo martesë ata nuk kanë fëmijë as që pritet lindja e tyre.

Gjykata bazuar në nenin 68 par.2 dhe nenin 69 par.1 dhe 2 e në lidhje me nenin 84 par.1 të Ligjit për Familjen e Kosovës, vlerësoi se janë plotësuar kushtet ligjore për zgjidhjen e kësaj martese ashtu që vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata, për shpenzimet e procedurës, vendosi në bazë të nenin 347 të LMFK-së që këto shpenzime propozuesit ti bartin bashkërisht.

Me sa u tha më lartë,u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË DEGA MALISHEVË
Departamenti i përgjithshëm Divizioni Civil
C.nr.420/2018 e datës 30.01.2019

Sekretarja juridike

Kryetari i trupit gjykues;

Fatime Hoti

Haki Kryeziu

KËSHILLË JURIDIKE: Meqenëse të autorizuarit e propozuesve pas shpalljes së aktgjykimit kanë hequr dorë nga e drejta e ankesës, ky aktgjykim bëhet i formës së prerë me datën 30.01.2019.